Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Blerje pajisje laboratorike “

Specifikimet teknike :

Lupe Binokulare

1. Te kene fushe te gjere shikimi me fokusim te thelle stereoskopik.
2. Mundesi rregullimi kendi 0° - 40° dhe zhvendosje larte / poshte 4mm-6 mm
3. Mundesi rregullimi te distances pupilare .
4. Zmadhimi 2.5 X -3.5 X me distance pune 34 mm – 42 mm
5. Fushe pamje Ø 5. Mm -90 mm

HB Meter

1. Aparati te jete I pershtatshem per analizen e hemoglobines totale, i lehte ne peshe dhe per tu perdorur.
2. Te jete e pajisur me bateri per matje mbi 100 ore ne menyre te vazhdueshme
3. Diapazoni I matjes 0-25.6 g/dL
4. Lineariteti: 0-20g/dL: +/- 0.3g/dL
4. Te kryeje matjen me sasi jo me madhe se 8uL
5. Koha e matjes te mos jete me shume se 60 sek
6. Metoda e matjes: fotometrike
7. Aparati te punoje me mikrokyveta pa reagent
8. Mikrokyveta te jete lehtesisht e perdorshme dhe te marre gjakun ne cdo kend
9. Sistemi optic te jete I kalibruar nga fabrika sipas standarteve NCCLS dhe te mos kete nevojë per mirmbajtje periodike
10. Mikrokyvetat te kene jetegjatesi jo me pak se 12 muaj nga koha e marrjes ne dorezim.
11. Pajisja te kryeje autokontroll ne menyre automatike
12. Te kete nderfaqe grafike ne ekran per te treguar hap pas hapi instruksionet ne perdorim
13. Mundesi lidhjeje me kompjuter nepermjet portave USB
14. Te ruaje rezultatet ne memorien e brendshme deri ne 4000 rezultate.
15. Mundesi identifikimi I pacienteve, operatorit, lotit te kyvetave nepermjet barkodeve.

Perzieres Portativ Per Sesion Levizes

(Aparat per perzierjen dhe peshimin e gjakut gjate dhurimit).

Mixeri duhet te kete tiparet e meposhtme:

1. Te ofroje nje peshe me precizion me te vogel se 1%, me variacion jo me shume se $\pm 3g$ per 0-500 gr
2. Pesha e matur nga pajisja nga 0-1000gram me hapa nga 1 gram.
3. Volumi i matjes nga 0-650ml me hapa nga 1 ml.
4. Te jete i pajisur me kleme per bllokim automatik te dhurimit me plotesimin e peshes/volumit target (sipas rregulloreve ne fuqi).

5. Te siguroje perzierjen e vazhdueshme me antikoagulantin nepermjet tundjes se gjithë perberjes ne qesen e gjakut, gjate kohes se dhurimit.
6. Te kete timer per arritjen e kohes maksimale te dhurimit qe nevojitet per prodhimin cilesor te komponenteve dhe te aktivizojë alarmin nese koha e programuar per kete qellim, tejkalohet.
7. Te bej kontrollin e rrjedhes se gjakut, me alarm si per rrjedhjen e larte, ashtu dhe per ate te ulet. Te jete i pajisur me barcode reader.
9. Te ofroje mundesine e kontrollit paralel te te dhenave (konfirmim te ID se dhuruesit, me ate te qeses dhe te tubave), si dhe te ruaje cdo informacion ne nje data-base te vet.
10. Te ruaje me shume informacion te jashtem te dhene nepermjet bar-codeve (lotin e qeses, skadencen, ID e dhuruesit, ID e operatorit, ID e tubave). Mundesi per
- te vendosur deri ne 4 programe te ndryshme te sasise se marre gjate dhurimit.
12. Te jete i pajisur me ekran me ngjyra me prekje ne te cilen te shfaqen te dhenat si koha e fillimit, koha e mbetur, sasia e marre dhe nderfaqja per vendosjen e rregullt te qeses sipas etapave.
13. Te jete i pajisur me porte Ethernet (Lan port RJ-45) per lidhje me rrjetin e bredshem per transmetimin e te dhenave.
14. Te kete opsionale lidhjen me Wireless
15. Te jete i pajisur me bateri me fuqi te larte rreth 10 Wh dhe mundesi per vendosje te baterie me te fuqishme deri ne 51 Wh.
16. Te jete i pajisur me te pakten 1 porte USB per ruajtje te te dhenave dhe 1 porte USB per lexuesin barcode.
17. Klasifikimi IEC 60601-1
18. Te jete i pajisur me kase transporti me porta karikimi te integruara per perdorim ne terren nepermjet baterise se brendshme.

Biomikser

(Aparat per perzierjen dhe peshimin e gjakut gjate dhurimit).

Mixeri duhet te kete tiparet e meposhtme:

1. Te ofroje nje peshe me precizion me te vogel se 1%, me variacion jo me shume se $\pm 3g$ per 0-500 gr
2. Pesha e matur nga pajisja nga 0-1000gram me hapa nga 1 gram.
3. Volumi i matjes nga 0-650ml me hapa nga 1 ml.
4. Te jete i pajisur me kleme per bllokim automatik te dhurimit me plotesimin e peshes/volumit target (sipas rregulloreve ne fuqi).
5. Te siguroje perzierjen e vazhdueshme me antikoagulantin nepermjet tundjes se gjithë perberjes ne qesen e gjakut, gjate kohes se dhurimit.
6. Te kete timer per arritjen e kohes maksimale te dhurimit qe nevojitet per prodhimin cilesor te komponenteve dhe te aktivizojë alarmin nese koha e programuar per kete qellim, tejkalohet.
7. Te bej kontrollin e rrjedhes se gjakut, me alarm si per rrjedhjen e larte, ashtu dhe per ate te ulet.
8. Te jete i pajisur me barcode reader.
9. Te ofroje mundesine e kontrollit paralel te te dhenave (konfirmim te ID se dhuruesit, me ate te qeses dhe te tubave), si dhe te ruaje cdo informacion ne nje data-base te vet.
10. Te ruaje me shume informacion te jashtem te dhene nepermjet bar-codeve (lotin e qeses, skadencen, ID e dhuruesit, ID e operatorit, ID e tubave). 11. Mundesi
- per te vendosur deri ne 4 programe te ndryshme te sasise se marre gjate dhurimit.

-
12. Te jete i pajisur me ekran me ngjyra me prekje ne te cilen te shfaqen te dhenat si koha e fillimit, koha e mbetur, sasia e marre dhe nderfaqja per vendosjen e rregullt te qeses sipas etapave.
 13. Te jete i pajisur me porte Ethernet (Lan port RJ-45) per lidhje me rrjetin e bredshem per transmetimin e te dhenave.
 14. Te kete opsionale lidhjen me Wireless
 15. Te jete i pajisur me bateri me fuqi te larte rreth 10 Wh dhe mundesi per vedosje te baterie me te fuqishme deri ne 51 Wh.
 16. Te jete i pajisur me te pakten 1 porte USB per ruajtje te te dhenave dhe 1 porte USB per lexuesin barcode.
 17. Klasifikimi IEC 60601-1

Ngjites (sealer)

Ngjitësat shërbejnë për ngjitjen me nxehtësi të tubave plastike te qeses së gjakut.

Qëllimi është të garantojë kushtet aseptike të përmbajtjes brenda qeses. Kjo pajisje duhet të plotësojë këto kritere:

- 1) Kompakt, i lehtë dhe jo i zhurmshëm gjatë përdorimit.
- 2) Te siguroje detektim optik te tubit,
- 3) Te jete i dizenuar per te bere ngjitje tubash te njome e te thate.
- 4) Drite sinjalizuese led per gjendjen e ngjitesit
- 5) Drite sinjalizuese led ne rast mosfunksionimi te ngjitesit
- 6) Të sigurojë ngjitje të shpejta në seri dhe hermetike, duke minimizuar kontaminimin bakterial dhe hemolizën e gjakut dhe produkteve të tij, per kete arsye trashesia e pajisjes te mos jete me shume se 7 cm per pregatitjen e segmentimit te shpejte te tubit.
- 7) Koka metalike e ngjitesit te jete e lehtë për tu hequr dhe per tu pastruar.
- 8) Per ngjitje te tubave PVC deri ne 6 mm
- 9) Koha e ngjitjes jo me shume se 3 sekonda
- 10) Te kete porta komunikimi COM In dhe COM OUT per lidhje ne seri.
- 11) Ushqimi duhet te jete 220-230V, 50-60Hz

Peshore Per Ndarje Gjaku

- 1-Të jetë e projektuar për matjen e saktë të peshës dhe vëllimit të gjakut dhe komponentëve.
- 2-Të bëjë konvertimin automatik të peshës në volum dhe anasjelltas për gjakun e plotë dhe komponentët.
- 3-Të jetë e pajisur me ekran LCD që tregon peshën dhe volumin me saktësinë 1 g ose ml.
- 4-Kalibrim automatik.
- Të punojë edhe me bateri deri në 12 orë.
- Të ofrojë mundësinë e ndërlidhjes me kompjuterin si edhe me modulën informatik (software) të qendrës së gjakut për regjistrimin dhe transferimin e të dhënave.
- Certifikatat: Certifikimi i produktit: CE ose US FDA i certifikuar; Certifikimi i cilësisë: i certifikuar ISO.

Ekstraktor manual per komponente gjaku

Sistem manual per ekstraktimin e komponenteve te gjakut. I pershtatshem per qese 100 ml, 200ml, 300ml, 400ml.

Centrifuge per kampione gjaku 8-12 vende

RCF maksimale: te pakten 3400
 RPM maksimale: te pakten 6000 /min
 Kapaciteti maksimal: te pakten 8 x 15ml
 Koha e punes: 1-99 minuta, pune e vazhdueshme, cikle te shkurtra
 Mbyllje e kapakut metalik me nje dore
 Me ekran qe tregon vlerat aktuale
 Motorr pa karboncina (brushless)
 Mundesi hapje te bllokuesit te kapakut ne rast emergjence
 EN / IEC 61326-1, class B
 Niveli i zhurmes: jo me shume se 50 dB
 Te shoqerohet me 40 cope tuba 15ml

Inkubator gjaku

Tensioni $230 \pm 10\%$ V,
 Konsumi i energjisë maksimale 500 W
 Gama e temperaturës së dhomës $22\text{ °C} \pm 2\text{ °C}$
 Kapaciteti 24 qese trombocyte 100 mL
 Siguria elektrike: Mbrojtja nga goditja elektrike - Klasa I
 Operacioni i vazhdueshëm
 Tundes i perfshire per kapacitet 24 qese 100 ml
 Cikle per minute: 65 +-7
 Mekanizmi i tundesit: I kontrolluar nga nje elektromotor 230V AC
 Kabineti i jashtëm Çelik i veshur

Tipi i tundesit: levizje horizontale
Dhoma e brendshme Çelik inox
Metoda e ftohjes: termoelektrike
Izolimi: Izolim poliuretani (PU) pa klorofluorkarbon (CFC)
Ekran LED
Intervali i shfaqjes së temperaturës 0,5 °C
Regjistrimi i temperaturës: Stilolaps boje në grafik letre, javore
Saktësia e sensorit të temperaturës $\pm 0,5$ °C
Gama e grafikut 0 °C deri në 40 °C
Intervali i grafikut 1 °C

Llamba 4 W tub LED
Hyrja e vlerësimit të mbrojtjes nga uji IPX-0
Temperatura e ambientit të punës: 10 °C deri në 33 °C
Bateri për regjistrues të temperaturës dhe njësia e kontrollit 12 V, 2,3 Ah bateri e ringarkueshme, e mbyllur dhe pa mirëmbajtje
Alarme (indikatore):
Sistemi
Modaliteti i ftohjes
Temperatura e lartë
Temperatura e ulët
Dera e hapur
Bateria e ulët
Tundes i fikur

Shpelaresh gjaku

- I pajisur me ekran me prekje me tregues gabimi dhe afishimine gjithë parametrave
- Te kete min 22 programe te ndryshme
- Min 3,500-4000 rrotullime ne min
- RCF: 1,430 -1600
- Kapaciteti min 24 vende per epruveta 5 ml
- Niveli i zhurmes ≤ 49 dB (A)
- I pajisur me kapak per mbyllje te lehte dhe me porte vezhgimi
- I pajisur me mesazh zanor pas përfundimit të centrifugimit
- Alarme ne forme teksti
- Alarme vizaule dhe akustike.
- Alarm per avari ne energjine elektrike.
- Alarm per temperature te larte /te ulet .

- Alarm kur dyert ngelen te hapura.
 - Alarm per avari te sondes se rtemperatures
 - Alarm per avari te kompresorit
 - Punim me bateri per min 72 ore . per alarme , te dhena dhe temperature ne rast nderprerje energjie , Paneli kontrollit
 - Ekran min 4,3" LCD
 - Shfaqjeje e grafikut te temp ne ekran .
 - Pajisur me Portë USB për ngarkim të lehtë të softuerit / shkarkim të të dhënave të regjistruara - për të mbledhur informacionin e regjistruar.
- Ushqimi 220/230 V 50/60Hz

Mikroskop binokular

- Mikroskop binokular, me drite
- Ndriçimi LED i bardhë me ndriçim të lartë qe mundeson te instalohet filter me diametër min 44 mm
- Okularë me rregullim dioptrie 10X
- Mekanizmi i fokusimit: Lart 3 mm/Poshtë 14 mm, 0.1-0.2 mm rotacion
- Tubi binokulare me këndi inklinimi: 30°-35°
- Distanca e pupilare: 55 - 75 mm
- Objektivat plan-akromat 4x.10x.20x.40x.60x.100x
- Kondensues drite Abbe 0.1-1.25 NA
- I trajtuar me boje antifungale rreth sistemit optik

Urinometer

- Operimi te jete automatik
- Per dedektim semi kuantitativ të gjakut (okult), urobilinogen, bilirubin, proteina, nitrite, ketone, glukozë, pH, dhe leukocitet në mostrën e urinës.
- Te jete i pajisur me ekran me prekje I cili shfaq min 10 parametra
- Te jete i pajisur me memorie min 200 teste duke perfshire rezultatet dhe emrin e pacientit
- Te kryeje 50 teste ne ore
- Mundesi lidhjeje me kompjuterin nepermjet portave USB dhe RS 232
- Kalibrimi te jryhet automatikisht
- Mundesi lidhjeje me skaner barkodi

Shtrat per dhurim gjaku

- I pajisur me min dy motorre elektrike
- Levizja e pjeses se shpines dhe e kembeve te kryhet me ane te motorreve elektrike te komandueshem me pult
- I pajisur me suporte krahu per dhurim gjaku

-
- Mbulese te jete lehtesisht e pastrueshme
 - Te jete i pajisur me stativ IV me lartesi te rregullueshme
 - Gjeresi 75-80 cm Gjatesi 110 -120 cm Lartesi 55-60 cm

Poltron per marrje gjaku

- Mbështetëse për krahët me mbulesë vinili
- Mbulese e karrges vinili që pastrohet lehtë
- Mundesi rregullimi manuale të mbështetëses së kokës dhe këmbëve
- Stativ IV teleskopik i lëvizshëm

3.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**Sasia e mallit që kërkohet:****Afate Sasia e mallit që kërkohet:**

“Blerje pajisje laboratorike”, me fond limit 6 265 054 (gjashte milion e dyqind e gjashtedhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e kater) leke pa tvsh .

Pajisje laboratorike

Nr	Artikulli	Njësia	SASIA
1	Lupe Binokulare	Copë	1
2	HB Meter	Copë	1
3	Perzieres Portativ Per Sesion Levizes	Copë	1
4	Biomikser	Copë	1
5	Ngjites (sealer)	Copë	1
6	Peshore per ndarje gjaku	Copë	1
7	Ekstraktor manual per komponente gjaku	Copë	1
8	Centrifuge per kampione gjaku 8-12 vende	Copë	1
9	Inkubator gjaku	cope	1
10	Shpelaresh gjaku	Copë	1

11	Mikroskop binocular	Copë	1
12	Urinometer	Copë	1
13	Shtrat per dhurim gjaku	Copë	1
14	Poltron per marrje gjaku	Copë	1

Afati I levrimit te mallit sipas kerkeses se autoritetit kontraktor nga 30 dite nga momenti I nenshkrimet te kontrates

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; (2% e vleres së fondit limit)*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2025 të njohura nga ana e njësisë vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore 2025 për secilin operator)*

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2025 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2025 per secilin operator).*

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 7).

b) Kërkohet deklaratë e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese ose vetëdeklarim i distributorit të autorizuar) per secilin artikull per respektimit te specifikimeve teknike te kërkuara nga shërbimi mjekësor.

***Argumentimi:** Ky kriter vendoset me qellim njohjen e origjines se mallit dhe kompanin prodhuese per identifikimin ne menyre te qarte gjate levrimin te tij dhe per te pasur siguri qe i njejti mall i ofruar do te levrohet ne destinacion ne perputhje me nenin 40 pika 6 dhe 8 te vkm 285 date 19.05.2021 “ Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Keto kerkesa i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise per njohjen e mundesise se operatorik ekonomik per permbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objektprokurimi.*

Mallrat te jene te certifikuara ne CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave te aprovuara.Kjo pike mund te plotesohet edhe nepermjet paraqitjes së autodeklaratës/deklaratë konformiteti (DC), nga operatori ekonomik.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione te autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”(nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit te artikullit ne Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve dhe te markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë/kuqe), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të

ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë në gjuhën shqip ose anglisht)

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike .

2. Neqoftese ka dokumenta ne gjuhe te huaj ato duhen te jene te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara .Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti , ose te dokumentave te rreme e te pasakta , konsiderohen si kusht per skualifikim .

6. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2008 ose 9001:2015 per distribuim, tregëtim të pajisjeve mjekësore Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates per tregëtim të materialeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është i certifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqiperisë.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me të nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me certifikimin e cilesise se mallrave objekt prokurimi.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas ligjit 89/2014 ”Per pajisjen mjekesore ”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a)Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2022,2023,2024) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlere e xhiros, për të

paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet përkatësisht në shumën prej **2 498 693.6 (dy milion e katërqind e nentëdhjetë e tete mije e gjashtëqind e nentëdhjetë e tre pike gjashtë) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.3-a) plotësohet duke paraqitur edhe vërtetimin përkatës të Administratës Tatimore

2.3-Kapaciteti teknik:

2.3-1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës **(),** që prokurohet dhe konkretisht jo më pak se **1 249 346.8 (një milion e dyqind e dyzet e nente mije e treqind e dyzet e gjashtë pike tete) leke pa t.v.sh**

dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)**–për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b)**–për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.5-a) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizoje/transportoje mallrat objekt kontrate, në vendet e percaktuara nga ana e Drejtorisë së Sherbimit Spitalor “Dr. Stefan Gjoni “Krujë me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK sipas kushteve të percaktuara në kontratë..

Shenim: Në zbatim të nenit 82.5 të Ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike⁶. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

⁶ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

- *Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontratës , në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimin. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorezuar perben kusht s'kualifikimi.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqese një deklaratë për furnizimin e pajisjes mjekesore sipa afatit të percaktuar*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqese një deklaratë ku të konfirmoj venien në punë të pajisjes mjekesore si dhe të trajnoje personelin për përdorimin e saj.*

Operatori ekonomik duhet të paraqese deklaratën e garancisë për pajisjen mjekesore në të cilën duhet të saktesojë se periudha e garancisë do të jetë të paktën një vit nga momenti i dorëzimit

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

•
nformacion mbi subjektet

mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁷.

⁷ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

